

MAKLENA NIKA

**VËSHTRIM GJUHËSOR PËR PASQYRIMIN E IMAZHIT POETIK,
DRITËS SURREALISTE DHE ELEMENTIT TË UJIT TEK ODISEAS
ELITIS DHE PAUL ELUARD**

Abstrakt

Në këtë kumtesë, do të trajtohen tre pika konvergjente në krijimtarinë poetike të shkrimtarit të madh grek të viteve 1930, *Odiseas Elitis* dhe shkrimtarit francez *Paul Eluard*. *Odiseas Elitis*, njohës shumë i mirë i krijimtarisë poetike franceze, shfrytëzon dhe zbaton në mënyrë të ndërgjegjshme përfundimet e tyre, veçanërisht të *Eluard* i cili kishte realizuar një hap vendimtar drejt hapësirës së ideve dhe përdorimit të fjalës poetike. Ai përbën në njëfarë mënyre një rast të veçantë brenda lëvizjes së surrealizmit. Pajtueshmëria dhe modestia karakterizojnë personalitetin dhe veprën e tij përkundrejt një surrealizmi fanatik dhe të njëanshëm të përfaqësuesve të tjerë. Ky është të paktën, poeti i “*Capitale de la Douleur*”, që ka njohur për herë të parë *Elitis*. Fjala, folja, shkrimi rifitojnë pastërtinë, virgjërinë dhe origjinalitetin e tyre. Gjuha poetike kthehet në gjuhën e admirimit, të transparencës, të të mistershmes dhe të magjisë. *Elitis* kishte fatin të zbulonte rastësisht – diçka që duhet theksuar veçanërisht – veprën e një poeti të madh, të një riorganizuesi dhe rinovuesi të fjalës poetike, të *Eluard*. Fakti se *Eluard* ishte një surrealist i përmbajtur, i cili respektonte estetikën tradicionale, e solli *Elitis* akoma edhe më afër poetit francez. Ky përkim në nivel psikosinteze e çoi *Elitis* drejt përshtatjes së veprës së *Eluard* me karakteristikat e hapësirës greke dhe drejt teknikës së tij. Veçojmë tre elementë të rëndësishëm në krijimtarinë e tyre, imazhin poetik (mjetin më të fortë shprehës së surrealizmit), dritën surrealistë dhe ujin, të cilët do të trajtohen në këndvështrim krahasues, përshkrues dhe analizues në poezi të përzgjedhura nga këta dy poetë bashkëkohës.

Imazhi poetik tek *Elitis* dhe *Eluard*

Imazhi bashkëkohor poetik është reflektim i një gëzimi, i një hidhërimi, i një ndjesie të çastit, por edhe asaj shekullore, i aftë të vërë në funksionim, brenda shpirtit, procesin e pjesëmarrjes organike në mrekullinë e botës:

“*Kape shkreptimën në rrugën tënde, njeri; jepi asaj vazhdimësi; mundesh!*”¹

Mund të themi se imazhi poetik i *Elitis* pranoi ndikime të forta nga imazhet poetike të *Eluard*. Ai përbën shprehjen verbale të ndjesisë së ngjeshur dinamike e cila lindet nga kontakti i poetit me botën e jashtme. Gjithashtu

¹ *Odiseas Elitis, Maria Nefeli, Botimet Ikaros, Athinë, 1999, f. 91.*

konsiston në një mënyrë zbulimi të botës së fantazisë dhe të shpirtit. Mbështetet mbi botën e dukshme, frymëzohet nga ajo, për ta çmaterializuar në vijim. Lëvizja e tij është e shumëfishtë. Ecën nga kohorja drejt të pakohorshmes, nga materialja drejt jomateriales, nga konkretja drejt abstraktes, nga toka drejt qiellit. Misioni i tij është të bëjë të ditur bukurinë e shpirtit. Imazhi i *Elitis* është shprehja plastike e një të bukure që shpreh gjendjen e ndërmjetme mes hyjnore dhe njerëzore, mes tokësore dhe qiellore.

Si në përkthimet ashtu edhe në vetë veprën elitiane, imazhet shfaqin ngjashmëri me ato të *Eluard*.

a) *Elitis* përzgjedhi për të përkthyer poezi të *Eluard* tek të cilat depërtimi i njeriut brenda botës fizike është shumë i fortë.

b) Imazhet janë pikë së pari erotike dhe zhvillohen rreth tematikës së erosit, të femrës, rreth trupit të njeriut në përgjithësi.

c) Dallohet një lëvizje nga toka drejt qiellit. Shkrimi është i ndritshëm, element i cili vërteton rëndësinë e madhe të tematikës së dritës për të dy poetët.

Një nga elementët e poezisë, dhe veçanërisht të imazhit poetik, të *Eluard* që joshi *Elitis*, është qëndrimi i poetit francez për t'u identifikuar me botën e jashtme. Tek *Eluard* konstatojmë se ruan njëfarë distance me botën e jashtme, ndërsa tek *Elitis* identifikimi është i plotë, dhe ndoshta përbën një nga arritjet më të mëdha të poezisë elitiane. *Eluard* ndoshta nuk e ndjen të nevojshme të identifikohet, ose ndoshta nuk arrin të identifikohet dhe të inkuadrohet tek bota e jashtme.

Bota e jashtme ekziston që femra të përshtatet me të. Përjasja e *Eluard* mbetet disi tradicionale. *Elitis* huazon nga *Eluard* pothuajse të gjithë përcaktimin e imazhit, adopton një qëndrim të njëjtë, por njëkohësisht ai zgjeron dhe plotëson kërkimin estetik të *Eluard*, duke përfunduar në një tezë të plotësuar dhe përfundimtare, si teorike ashtu edhe teknike. Le ta dëgjojmë *Elitis*:

“....Përkundrazi, në poezitë e sotme bota shpërthen në mënyrë të admirueshme dhe është çfarë do të jetë çdo herë. Analogjia i lë vendin e saj identifikimit. Ky është ai...”².

Identifikimi, sipas tij, është një surprizë, një bombë e cila shpërthen duke aktivizuar lidhjen instiktive primitive dhe të palogjikshme me botën:

“Befasia, e madhe ose e vogël, nuk lë kohë për askënd të mendojë se një gjë mund të jetë ose mund të mos jetë kështu”³.

Le të shohim metamorfozën e kënaqësisë së botës së *Elitis*:

“Bashkë me to (vajzat) unë, dorën lëviz

Poeti i reve dhe i dallgëve!

Në teneqenë modeste me ngjyrën zhytem

Penelet bashkë me to dhe lyej”

² Odiseas Elitis, *Letra të Hapura*, Botimet Ikaros, Athinë 2009, f. 147.

³ *Letra të Hapura*, si më lart, f. 147.

(“*Aksion Esti*”⁴)

Në pjesën e mësipërme, *Elitis* mund të përdorte krahasime të thjeshta me ndihmën e “si”, për të lidhur dy objekte në distancë nga njëri tjetri ose për të provokuar metamorfozën e një elementi në një tjetër (p.sh. “*dorën lëviz (si) Poet...*” ose “(si piktor) *zhys penelat...*”).

Pra është e qartë dhe e dukshme se *Elitis* shfrytëzon arritjet e teknikës dhe të kërkimit estetik të *Eluard* dhe i përdor ato si mbështetje në poezinë e tij, por nuk kufizohet në zhvlerësim, por zgjeron dhe perfeksionon idetë e poetit francez përse i përket drejtimit të transparencës, të pastërtisë dhe të ngjashmërisë.

Drita surrealistë tek *Elitis* dhe *Eluard*

Drita për *Elitis* është elementi që lejon shkrirjen ndërmjet poetit dhe botës organike. Kjo tezë shpjegohet nga funksionimi i dritës si elementi fizik. Dhe në vërtetë, nëse jemi në gjendje që të shikojmë, të kuptojmë dhe të depërtojmë në hapësirën tonë shoqërore dhe kozmike, kjo ndodh falë dritës që tret errësirat.

Drita lejon ekzistencën e të parit; i pari në poezi është i identifikueshëm me imazhin, dhe surrealizmi dhe imazhi janë dy terma që varen nga njëri-tjetri. Në bazë të këtij arsytimi, kuptojmë me lehtësi deklarin e *Elitis* në bazë të të cilit ai përshtati disa elementë të surrealizmit me dritën greke⁵.

Elitis forcon vërejtjen e tij me kërkimin e misterit brenda thjeshtësisë dhe të përditshmes. Në kundërshtim me europianët, grekët e kanë gjetur gjithnjë misterin brenda dritës. Edhe *Elitis* këtë bën tek shpjegimi i tij tek “*Letra të Hapura*”, ku përmend disa eksperiencat gjatë stinëve të verës greke:

“*Dhe mrekullia erdhi sërish një verë tjetër në mes të ditës dhe të detit – muaji korrik dhe ora njëmbëdhjetë -Pashë mbrapa nesh shkreptëmat e arta, lakoret mes dritës...dhe shpirti mbeti i vetëm, pa rrudha, shpirti në dritë i lirë...*”⁶

Shkrimi i *Elitis* është eliptik, pothuajse afrohet me gjuhën popullore të folur, kur transmeton një ndjesi të një njeriu përpara një mrekullie fizike të përditshme.

Imazhet tek “*Aksion Esti*” janë si shkreptima, të pafundme dhe ndriçojnë mes kohëzgjatjes së tyre:

Në fillim drita

AKSION ESTI drita

Një mrekulli që djeg në qiej lëmet

Dhemb i guximshëm brenda shpirtit të diellit

(“*Aksion Esti*”)

⁴ Odiseas Elitis, *Aksion Esti*, Botimet Ikaros, Athinë, 1958 (botimi i parë), f. 41.

⁵ *Letra të Hapura*, si më lart, f. 348-49.

⁶ *Letra të Hapura*, si më lart, f. 350-51.

Duke e adoptuar dritën si hyjni absolute, *Elitis* i rikthehet traditës platonike. Drita simbolizon dijen; por është edhe apoloniane (rregull, qëndrueshmëri, krijimtari), por njëkohësisht edhe dionisiake (apoteozë orgjie e jetës, himn për lumturi tokësore, absurditet dhe çrregullsi). Drita do të thotë qytetërim dhe aventurë ekzotike e Lindjes, por edhe dija dhe shpirti i Perëndimit:

*Duke i dhënë pushtet dritës së lashtë
Dhe drita nuk u lidh kurrë me mbrojtjen dhe velin e tyre*
(“*Aksion Esti*”⁷)

Me një dritë tërfili në gjoksin tim
(“*Orientimet*”⁸)

Në traditën greke, drita përbën shprehjen e palogjikshme, diakronike të Greqisë, shpresën dhe perfeksionin e njeriut. Jeta është një fenomen i ndritshëm dhe shpresëdhënës, ndërsa vdekja është pikërisht e kundërta. *Elitis* është poeti i jetës, dhe, duke e pagëzuar shkrimin e tij me dritën, e drejton vazhdimisht drejt jetës. Me këtë skeptikë e keqja, errësira dhe pesimizmi burojnë nga zhdukja e përkohshme e Diellit dhe nuk janë veçse fenomene të përditshme që luftojnë kundër përjetësisë. Por edhe në brendësinë e njeriut, e keqja është rezultat i një zhdukjeje të përkohshme të Virtytit, domethënë e vlerës që shpreh, pikërisht drita në nivel moral. “*Aksion Esti*” na propozon një shembull perfekt të këtij fenomeni dhe të këtij konceptimi.

Drita greke më hapi sytë, depërtoi në poret e mia për të zgjeruar gjithë qënien time. E ndjeva botën si shtëpinë time, kisha zbuluar qendrën e të vërtetës, kuptova me saktësi kuptimin e revolucionit.....Por kategorikisht mohoj ta nënshtroj veten time në të ardhmen tek ajo cilësi e qytetarit të botës që fitova heshturazi, në këmbë përpara varrit të Agamemnonit. Që nga ajo ditë, ia kushtova jetën time rimëkëmbjes së karakterit hyjnor të njeriut. Paqe për të gjithë njerëzit, thashë, dhe më shumë jetë.

Kështu përfundon vepra e tij, duke vërtetuar tezat e *Elitis*.

Drita është element që lidh shumë thellë të dy poetët. Funkcioni dhe roli i saj brenda në poezinë e *Elitis* nuk është rezultat i ndikimit të poetit francez tek poeti grek. Vetë *Elitis* përzgjedhi për të përkthyer nga *Eluard* “pjesë të ndritshme të veprës së tij”.

*NË AGIME SA TË DUA në venat e mia e gjithë nata rrjedh
Që e kalova duke të vështruar
Të pashpjegueshme më dukeshin të gjitha
Njoh vetëm errësirat
Këto janë që më japin forcën
Për të të mbajtur në gjoksin tim shtrënguar*

⁷ Odiseas Elitis, *Aksion Esti*, si më lart, f. 42.

⁸ Odiseas Elitis, *Orientimet*, Botimet Ikaros, Athinë 1982, f. 128.

*Në gjoksin tim të qetë për të të tronditur
Për të të zbuluar
Për të të çliruar dhe për të të humbur
Zjarr në mes të dritës i padukshëm
Dhe nëse bën sikur ikën ja: ku dera të nxjerr në mes të dritës
Dhe nëse bën sikur ikën ja: ku dera të nxjerr mbi mua.*

*Në të vërtetë, drita më verbon
Drita ime ndërkohë, ka dhënë imazhe, negativisht të takimeve tona.*

Elementi i “Ujit” tek *Elitis* dhe tek *Eluard*

Uji është element që materializon lëvizshmërinë botërore, aposintezën dhe shkëputjen e botës mes gjendjes së tij materiale dhe ecurisë diakronike. Uji që rrjedh nuk kthehet mbrapsht.

Nuk jemi në gjendje të mbështesim faktin nëse kthimi i *Elitis* tek *Herakliti* realizohet nëpërmjet surrelizmit. Një hipotezë e tillë duket e pamundur nëse do të kishim parasysh se poeti që në moshë të vogël ishte mësuar me këtë filozofi. Por mund të shtojmë se surrelizmi ishte si një stimul shtesë në adoptimin përcaktues të mendimit heraklitian. Le të shohim disa pjesë të *Eluard* përkthyer nga *Elitis* që përmbajnë elementin e lëngshëm:

*Ku të shterin çezmat e ditëve të pafajshme
Duart sikurse çezmat
Lehtësisht përkundin dhe lehtësisht lëvizin erën
Dhe deti*

Le t'i krahasojmë me imazhet autentike elitiane, ku roli i ujit është, në të vërtetë, transformues:

E gjithë bota tokë dhe ujë

(“*Orientimet*”⁹)

E njëjta pikë ujë është edhe Virtyti

(“*Maria Nefeli*”¹⁰)

Pak ujin për ta patur zot

(“*Aksion Esti*”¹¹)

Imazhet e *Elitis* kanë aromë transparence dhe thellësie të një deti shekullor, duke u larë në pikat e shiut grek. Ky është edhe universi poetik i veprës elitiane.

Elitis është me prejardhje nga Mitilini, lindi në Iraklio të Kretës dhe jetoi në Athinë. *Kimon Freirer* ka përcaktuar trinomin toponimik *Mitilini – Athinë – Kretë* si hapësirën frymëzuese për *Elitis*. Pikërisht kjo eksperiencë e Egjeut

⁹ Odiseas Elitis, *Orientimet*, si më lart, f. 80.

¹⁰ Odiseas Elitis, *Maria Nefeli*, si më lart, f. 93.

¹¹ Odiseas Elitis, *Aksion Esti*, si më lart, f. 16.

dhe e detit në përgjithësi bën shfaqjen e saj spektakolare në poezinë e viteve 1930, duke plotësuar në këtë mënyrë panoramën e copëtuar të Greqisë.

“Elitis gjeti tek Egjeu atë çka Aragon, Eluard dhe surrealistët e tjerë gjetën në rrugët e Parisit”, do të shprehet Robert Jouanny. Egjeu, i vërtetë si vetë Greqia, i paparashikueshëm dhe ekstatik, është një sintezë perfekte e mitit, e elementit të mbinatyrshëm, e befasisë dhe e fantazisë, pikërisht si një përrallë magjike që riprodhohet pa pushim nga parimi i kohës.

Nëpërmjet këtij identifikimi *Elitis* përjeton të përditshmen e një njeriu të thjeshtë, me fuqinë e ndjenjës dhe jo me privimet e mendjes.

“Çdo çast duhet të ishte tashmë një çast i një realiteti të ri, rezultat i një ndërhyrjeje të re të guximshme brenda botës. Revolucioni duhet të dëshmojë vetë energjinë transformuese në veprim dhe në fjalë, të nënkuptojë vetë analogjitë në realitetin e jashtëm dhe të brendshëm të njeriut”.

(“Letra të Hapura”¹²)

Kështu lindet dhe përjetohet surrealistet, një surrealistet i cili në rastin e Egjeut, nuk është veçse realiteti i përditshëm, ekzistues, i dukshëm.

“...jeta dhe arti, nuk janë veçse dy enë komunikuese ku, realiteti i brendshëm dhe i jashtëm, rrjedhin dhe përbëjnë në mënyrë të pandërprerë, një realitet të vetëm: surrealistet”.

(“Letra të Hapura”¹³)

Pra, një koncept i *Elitis* për surrealistet është ai që ndodhet brenda Egjeut dhe që zbulohet vazhdimisht nga ndjenja poetike në përmasat e saj diakronike dhe bashkëkohore. Kryesisht është një lidhje erotike kjo e *Elitis* me detin. Le ta konkretizojmë tek *“Marina e shkëmbinje”*.

“Marina e shkëmbinje”

*.....ke një shije stuhie në buzë
Dhe një fustan të kuq si gjaku
Thellë brenda arit të verës
Dhe aroma e zymbylëve - ku ktheheshe*

Duke zbritur drejt gjireve të qelqta me guriçkat

(“Orientimet”¹⁴)

Marina është një vajzat më të dashura për *Elitis* (e ndeshim edhe tek *“Aksion Esti”*); ajo mishëron në nivel ndjenje, lidhjen ndërmjet femrës dhe detit, është forma bashkëkohore e Afërditës. Ajo është *femra – det*. Egjeu është për *Elitis* burimi shekullor i mrekullive, i magjisë dhe i plotësimit, vetë identiteti i Helenizmit. Ky konceptim helenocentrik përbën një pikë të përbashkët për shkrimtarët e viteve 1930. Dashuria pasionante për Greqinë

¹² Odiseas Elitis, *Letra të hapura*, si më lart, f. 112.

¹³ Odiseas Elitis, *Letra të hapura*, si më lart, f. 113.

¹⁴ Odiseas Elitis, *Orientimet*, si më lart, f. 128.

përkthehet në kërkimin e identitetit të ri grek, dhe është përgjigja e kompleksit të inferioritetit që karakterizonte brezat e mëparshëm. Zbulimi i Egjeut nga poezia e periudhës ndërmjet dy Luftërave Botërore ishte një stimul bazë në formulimin e kësaj ideologjie.

Surrealizmi nuk e ndihmoi *Elitis* vetëm për të zbuluar dhe për të futur në poezinë e tij botën e nënvlerësuar të Egjeut. Kontribui gjithashtu në harmonizimin shpirtëror dhe moral të dy formave të dhëna të Greqisë si botë gjeografike, shpirtërore dhe morale. Kjo natyrë e unifikuar greke do të jetë hapësira ku parimet e surrealizmit do të gjejnë ekzistencën e tyre organike. Në këtë pikë do të mund të theksonim edhe një veçori thelbësore ndërmjet surrealistëve grekë dhe atyre francezë.

Kemi përmendur më lart maninë me të cilën francezët hidhnin poshtë “vlerat kombëtare”, ose çfarëdolloj gjëje tjetër që lidhej me temat “patriotike”. Hedhja poshtë e këtij vizioni për një revolucion të përgjithshëm, individual dhe shoqëror, e çoi grupin e Parisit drejt një forme nihilizmi. Ndërsa surrealistët grekë kërkuan dhe gjetën surrealitetin e tyre brenda vlerave të qytetërimit të tyre, në natyrën e vendit të tyre dhe në identitetin e tyre historik dhe kulturor. Nga ky këndvështrim, futja e elementit të Egjeut në poezi shënon fillimet e një periudhe uniteti moral ndërmjet vlerave dhe ndërgjegjes së Greqisë së Re.

BIBLIOGRAFI

- Odiseas Elitis, *Maria Nefeli*, Botimet Ikaros, Athinë 1999.
Odiseas Elitis, *Letra të Hapura*, Botimet Ikaros, Athinë 2009.
Odiseas Elitis, *Aksion Esti*, Botimet Ikaros, Athinë, 1958 (botimi i parë).
Odiseas Elitis, *Orientimet*, Botimet Ikaros, Athinë 1982.

